



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

**Nr. 201, datë 11.06.2020**

#### PËR

### **FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATËT NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMIN NR.83, DATË 26.02.2020 DHE VENDIMIN NR.86, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136 dhe 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pikat 2 e 3 dhe nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

#### V E N D O S I :

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.83, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit si më poshtë:
  1. Për kandidatin z. {...} - relator z./znj. Marçela Shehu.
  3. Për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre, sipas rastit, për një ose të

dyja pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020.

4. Mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.
5. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.
6. Disponimi sipas pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi, u njoftohen aplikuesve z. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
7. Aplikuesit z. {...} dhe znj. {...} kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit respektivisht të pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**